



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë

Tel/Fax: 04 2268141; 2268142

Nr. 85 Prot.

Tiranë, më 08.02.2017

V E N D I M

Nr. 14, datë 08.02.2017

“Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 109, datë 02.11.2016 dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 01.08.2016 e në vazhdim”

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil mbikëqyr, kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civil, nxjerr vendime paralajmëruese në rast se konstaton parregullsi dhe përcakton detyra konkrete për rregullimin e situatës.

Për këtë arsye:

Në zbatim të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenet 11/1 dhe 14 , të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nenit 34 e vijues të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues nr. 109, datë 02.11.2016, të Komisionerit, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë realizimit të procedurave për rekrutim, transferim, ngritje në detyrë, në Agjencinë Kombëtare të Duhan - Cigareve, prej datës 01.08.2016 (*momenti i përfundimit të mbledhjes së dokumentacionit nga ana e Komisionerit mbi bazën e të cilave u analizua situata në shërbimin civil gjatë mbikëqyrjes*) e në vazhdim.

VENDOSA:

1. Fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 109, datë 02.11.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në institucionin Agjencia Kombëtare e Duhan - Cigareve, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave”.
2. Verifikimin e akteve të emërimit, të cilat kanë dalë në kundërshtim me kërkesat e ligjit, duke mosrespektuar procedurat e rekrutimit, në Agjencinë Kombëtare të Duhan-Cigareve, prej datës 01.08.2016 (*momenti i përfundimit të mbledhjes së dokumentacionit nga ana e Komisionerit mbi bazën e të cilave u analizua situata në shërbimin civil*) e në

vazhdim, sipas objektit dhe aneksit që përmban Programi i Verifikimit, i cili është pjesë e këtij vendimi.

3. Ngritjen e grupit të punës, me këtë përbërje:

1. Altin Shumeli	Drejtor i Mbikëqyrjes
2. Valentina Kolleshi	Inspektore, Drejtorja e Mbikëqyrjes
3. Stela Ndoka	Specialiste, Drejtorja e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë

4. Ky proces do të fillojë me paraqitjen e grupit të punës në subjekt, në datën **10.02.2017** dhe do të përfundojë më datën **21.02.2017**.
5. Me përfundimin e verifikimit të akteve, grumbullimit të dokumentacionit dhe të dhënave në subjekt, grupi i punës, do të vijojë punën me përpunimin e të dhënave. Aktet e konstatimit, procesverbalet e mbajtura në subjekt, si dhe dokumentacioni i administruar, lidhur me zbatimin e vendimit të Komisionerit dhe verifikimin e ligjshmërisë së emërimeve të kryera nga institucioni, do t'i paraqiten për të vijuar procesin respektivisht Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Mbikëqyrjes dhe Inspektimit, brenda datës **14.02.2017**. Relacionet përkatëse duhet të përpilohen deri në datën **17.02.2017**. Më pas do t'i paraqiten për miratim Komisionerit, dhe më tej, do të hartohen vendimet për përmbylljen e proceseve, brenda **4** ditëve.
6. Vendimi përfundimtar dhe vendimi paralajmërues i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për përmbylljen e procedimit administrativ (*verifikimit*) do t'i dërgohet subjektit të mbikëqyrur Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve, Njësisë Përgjegjëse (*Departamentit të Administratës Publike*) dhe Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave.
7. Ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit dhe Drejtorja e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, që të marrin masat për realizimin e procesit, duke filluar me njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes në përputhje me nenin 42, të Kodit të Procedurave Administrative dhe të akteve që janë pjesë e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi Zogu I-rë, Godina 57, shk.2, Nr.18. Tiranë

Tel: 355 4 2268 142; Fax: 355 4 2268 141

Nr. 85/1 Prot.

Tiranë, 08.02.2017

M I R A T O H E T

Pranvera STRAKOSHA

KOMISIONER

PROGRAM VERIFIKIMI

(Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 109, datë 02/11/2016, dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga institucioni i Agjencisë Kombëtare të Duhan - Cigareve, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 01.08.2016 e në vazhdim).

1. Subjekti i mbikëqyrjes: Agjencia Kombëtare e Duhan - Cigareve

2. Objekti i verifikimit: Zbatimi i Vendimit paralajmërues nr. 109, datë 02.11.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në institucionin Agjencia Kombëtare e Duhan - Cigareve, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Verifikimi i akteve të emërimit, të cilat kanë dalë në kundërshtim me kërkesat e ligjit, duke mosrespektuar procedurat e rekrutimit, në institucionin e Agjencisë Kombëtare të Duhan-Cigareve, prej datës 01.08.2016 (momenti i përfundimit të mbledhjes së dokumentacionit nga ana e Komisionerit mbi bazën e të cilave u analizua situata në shërbimin civil gjatë mbikëqyrjes) e në vazhdim.

3. Baza ligjore: Neni 14, i ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe neni 34 e vijues i rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

4. Periudha e verifikimit:

Fillon me datën e daljes së Vendimit paralajmërues të Komisionerit nr. 109, datë 02.11.2016 *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në institucionin Agjencia Kombëtare e Duhan - Cigareve, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave”*, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi dhe në datën e përfundimit të mbikëqyrjes në subjekt (01.08.2016), për rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin.

5. Afati i verifikimit:

Verifikimi do të fillojë në institucion në datën 10.02.2017 dhe do të përfundojë brenda datës 21.02.2017.

6. Procedura që do të ndiqet:

Për parregullsitë e konstatuara do të mbahen aktet e konstatimit, procesverbal administrativ, të cilët nënshkruhen nga grupi i verifikimit dhe personat përgjegjës, si dhe do të merret kopja e dokumentacionit përkatës, vërtetuar nga sekretaria e institucionit.

7. Grupi i punës:

1. Altin Shumeli	Drejtor i Mbikëqyrjes
2. Valentina Kolleshi	Inspektore, Drejtorja e Mbikëqyrjes
3. Stela Ndoka	Specialiste, Drejtorja e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë

8. Dokumentimi i rezultateve të verifikimit:

Në përfundim të procesit të verifikimit dhe mbikëqyrjes do të përgatiten relacionet përkatëse nga Drejtorja e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, dhe Drejtorja e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit, bazuar në aktet e konstatimit dhe procesverbalet e mbajtuara në subjektin e verifikuar si dhe do të administrohet dokumentacioni provues. Më pas do të hartohet vendimi përfundimtar i procedurave përmbyllëse të verifikimit të zbatimit të vendimit, i cili do të dërgohet institucionit (*nëse vendimi nuk është zbatuar, Komisioneri do të zbatojë kompetencën e parashikuar në nenin 15, pika 2, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar*) dhe vendimi paralajmërues në përfundim të verifikimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative lidhur me emërimet e dala në kundërshtim me ligjin.

DREJTIMET E VERIFIKIMIT

- I. Si janë zbatuar, detyrat e lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Vendimin nr. 109, datë 02.11.2016 *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në institucionin*

Agjencia Kombëtare e Duhan - Cigareve, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave”, nga ana e Njesisë Përgjegjëse Departamentit të Administratës Publike dhe Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit të mbikëqyrur. Në këtë rast, verifikimi do të realizohet duke pasur parasysh nivelin e zbatimit të urdhërimeve në vendimin paralajmërues, si më poshtë, duke administruar kopje të akteve që materializojnë zbatimin e vendimit:

- “2. Njësia burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur në bashkëpunim me njësinë e burimeve njerëzore të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Departamentin e Administratës Publike, gjatë shpalljes së procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, duhet të kujdesen për të saktësuar, të drejtën për të konkurruar, duke përfshirë jo vetëm nëpunësit e të njëjtës kategori, por edhe pozicionet analoge, me emërtesa atipike, të cilat i përkasin kryesisht institucioneve që kanë hyrë rishtas në shërbimin civil dhe ndërkohe funksionojnë me legjislacionin, i cili ka qenë në fuqi, para hyrjes në shërbimin civil.

Për të siguruar zbatimin e ligjit në këtë drejtim, duhet të përshtasin legjislacionin specifik me ligjin për shërbimin civil, me qëllim që të eliminohet mospërputhja që krijohet në emërtesat e pozicioneve të punës dhe nivelin e pagës, me klasifikimin e pozicioneve në legjislacionin për nëpunësin civil.

Të pasqyrohen këto raste edhe në përshkrimin e punës për pozicionet konkrete, ashtu si është rasti i Drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Duhan – Cigareve në këtë institucion.

3. Institucioni i mbikëqyrur, duhet të organizojë punën për nënshkrimin e përshkrimit të punës nga nëpunësit civilë të rekrutuar rishtas, duke krijuar mundësinë e njohjes dhe dakordësinë e tyre me dokumentin.

Gjithashtu, mbështetur në dispozitat ligjore, i gjithë procesi i hartimit, miratimit dhe nënshkrimit të përshkrimeve të punës nga strukturat përgjegjëse, pjesëmarrëse në këtë proces, duhet të përfundojë me dokumentimin e tyre, duke i depozituar në Departamentin e Administratës Publike dhe më pas një kopje, duhet të vendoset në dosjen individuale të personelit.

4. Strukturat e institucionit, përgjegjëse për vlerësimin, të përfundojnë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë për 6 mujorin e parë të vitit 2016, sipas procedurave të hollësishme të parashikuara në vendimin nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, të ndryshuar dhe lidhjes nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi, si dhe sipas rekomandimeve të materializuara në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes.

Në vazhdim, të përmbyllë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë për drejtorin e institucionit, duke i përcjellë zyrtarisht, titullarit të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (si institucion nga i cili varen), formularin e vlerësimit. Më tej të vazhdohet procedura e hollësishme për vlerësimin e tij, sipas përcaktimeve të legjislacionit për nëpunësin civil.

5. Të plotësohet dosja e personelit me të gjitha dokumentet e evidentuara në mungesë, në tabelat aneks, bashkëlidhur këtij raporti, sipas orientimeve në raportin e mbikëqyrjes.

6. *Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 30 ditë nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.”*

Në rast të konstatimit të moszbatimit të pjesshëm apo të plotë të vendimit të Komisionerit, do të mbahet procesverbal konstatimi, i cili do të nënshkruhet nga grupi i punës dhe personi përgjegjës.

- II. Verifikimi i ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera nga ky institucion, lidhur me emërimet të cilat kanë dalë në kundërshtim me kërkesat e ligjit, duke mos u respektuar procedurat e rekrutimit, duke filluar nga data 01.08.2016 (*momenti i përfundimit të mbledhjes së dokumentacionit nga ana e Komisionerit mbi bazën e të cilave u analizua situata në shërbimin civil*) e në vazhdim. Në rast të konstatimit të veprimeve të parregullta që kanë të bëjnë me këtë institut të ligjit, do të administrohen kopje të akteve, si dhe do të procedohet me procesverbal konstatimi, i cili do të nënshkruhet nga grupi i punës dhe personi përgjegjës.

Aneks i programit: Aktet administrative që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit.

Në vijim të programit të verifikimit, më poshtë po rendisim aktet që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit për të përfunduar këtë proces.

1. Provat shkresore të cilat vërtetojnë zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me vendimin paralajmërues.
2. Struktura organizative dhe analitike e institucionit që ka qenë në fuqi në momentin e mbikëqyrjes dhe ajo aktuale.
3. Listëpagesat dhe listëprezencat e institucionit, duke filluar nga momenti e mbikëqyrjes së mëparshme deri tek ato aktuale.
4. Aktet administrative të cilat materializojnë emërimet në kundërshtim me ligjin, (aktet e emërimit/ kontratat e përkohshme të punës) pas datës 01.08.2016.
5. Dosjet personale të nëpunësve të emëruar pas verifikimit të kryer në kuadër të mbikëqyrjes.
6. Materiale të tjera të cilat do të konsiderohen të domosdoshme për verifikimin e situatës së shërbimit civil në këtë institucion, gjatë procesit të verifikimit.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM
I INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Arbana BASHA

**DREJTORI I ÇËSHTJEVE JURIDIKE
DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË**

Enkelejda HEBIBASI